

VAKSINIME PËR TË GJITHË

Vaksina COVID-19 nga Pfizer

- + Dozat për të rriturit
- + Dozat për fëmijë nga 6 muajsh e lart
- + Dozat shtesë të serisë primare për personat me imunitet të cenuar
- + Injeksionet përforcuese

Ofrohen këtu për të gjithë ata që kualifikohen

Me COVID-19 është më e rëndësishme se kurrë të mbron veten dhe ata pranë jush nga sëmurja.

Vaksinat kundër COVID-19 janë të sigurt dhe tejet efikase në reduktimin e rrezikut nga sëmurja, shtrimi në spital dhe deri dhe vdekja.

Vaksinën kundër COVID-19 mund ta bëni pa shpenzime nga ana juaj.

Mësoni më tepër se cila vaksinë është e duhura për ju. Skanoni kodin QR ose telefononi në nr. **1-844-NYC-4NYC** (1-844-692-4692)

Mësoni më shumë për vaksinat kundër COVID-19



Kush duhet të vaksinohet kundër COVID-19?

- + Fëmijët e moshës 6 muajsh deri 4 vjeç mund të bëjnë tri doza pediatrike (një e dhjeta e fuqisë) së Pfizer-BioNTech
- + Fëmijët e moshës 5-11 vjeç mund të bëjnë dy doza pediatrike (një e treta e fuqisë) së Pfizer-BioNTech
- + Fëmijët dhe të rriturit 12 vjeç e lart mund të bëjnë dy doza të vaksinës Pfizer-BioNTech
- + Të rriturit 18 vjeç e lart mund të bëjnë dy doza të vaksinës nga Moderna ose një dozë të Johnson & Johnson/Janssen
- + Fëmijët dhe të rriturit 5 vjeç e lart që kanë sistem të dobësuar imunitar për shkak të një sëmundjeje apo trajtimi mund të bëjnë një dozë shtesë të serisë primare nga Pfizer - të njohur edhe si doza e tretë.

Kush duhet të bëjë injeksion përforcues kundër COVID-19?

Gjithkush nga 5 vjeç e lart duhet të bëjë një injeksion përforcues të paktën pesë muaj pas bërjes së dozës së dytë të serisë primare të Pfizer ose Moderna të vaksinimit kundër COVID-19.

Personat që kanë kryer dy injeksione të vaksinës Pfizer ose Moderna duhet të kryejnë të njëjtën vaksinë si përforcuesja, por kanë mundësinë e kryerjes së cilësdo prej tri llojeve të vaksinave të autorizuara në SHBA.

Personat 5-17 vjeç që kanë bërë më parë serinë primare të Pfizer mbi pesë muaj më parë përfitojnë vetëm injeksionin përforcues të Pfizer.

Gjithkush nga 18 vjeç e lart që ka bërë vaksinën nga Johnson & Johnson duhet të bëjë një injeksion përforcues të paktën dy muaj pas bërjes së dozës së parë. Injeksionet përforcuese nga Pfizer ose Moderna (vaksinat me mRNA kundër COVID-19) preferohen në shumicën e rasteve.

Personat me imunitet të cenuar që kanë bërë J&J si dozë të parë dhe një vaksinë me mRNA të paktën 28 ditë më vonë si dozë shtesë, duhet të bëjnë një dozë përforcuese të një vaksine me mRNA të paktën dy muaj pas dozës shtesë të vaksinës me mRNA, për tri doza gjithsej.

Spitalet në sistemin e NYC Health + Hospitals ofrojnë vaksinat Pfizer dhe J&J. Qendrat e NYC Health + Hospitals/Gotham Health ofrojnë vaksinën nga Moderna dhe Pfizer për fëmijët e moshës 5-11 vjeç. Për një listë të plotë të pikave, vizitoni faqen tonë në internet: nychealthandhospitals.org.